



PRISHTINA

---

# RAPORTI I PUNËS SË KRYEQYTETIT

Janar - Korrik 2023

***KY RAPORT PASQYRON  
TË ARRITURAT E EKIPIT  
TË KRYEQYTETIT***

Prishtinë, 2023

# PËRMBAJTJA

Fjala Hyrëse e Kryetarit Përparim Rama **Faqe 4**

**01** Prishtina për Infrastrukturën **Faqe 6**

**02** Prishtina për Sportin **Faqe 18**

**03** Prishtina për Kulturën **Faqe 26**

**04** Prishtina për Parqet dhe Hapesirat Publike **Faqe 32**

**05** Prishtina për Arsimin **Faqe 38**

**06** Prishtina për Shëndetësinë **Faqe 46**

**07** Prishtina për Teknologjinë **Faqe 50**

**08** Prishtina për Sigurinë **Faqe 54**

**09** Prishtina për Bujqesinë **Faqe 58**

# FJALIMI PËR RAPORTIN GJASHTËMUJOR

*Të dashur qytetarë,*

Këtë vit e filluam me përkushtim e një energji drejt përmbushjes së vizionit tim për transformimin e Kryeqytetit në një mjedis më miqësor për këmbësor, më të gjelbër e më të shëndetshëm. Rrjedhimisht, një numër i madh projekteve që janë hartuar dhe tenderuar përgjatë vitit 2022 kanë filluar të zbatohen me një dinamikë të madhe në këtë gjashtëmuor.

Nisëm një prej projekteve më të mëdha infrastrukturore të realizuar ndonjë herë në Kryeqytet, **rrugën Jim Xhema**. Një rrugë që, përpos që zgjidh problemin e kolektorit, do të krijojë **një jetë të re për rreth 20,000 qytetarë të Prishtinës**. Ky projekt i ka sjellë Kryeqytetit **punësim e zhvillim, një standard të ri të ndërtimit, rrugë të gjëra me kors për autobusë e biciklistë**.

Për të **përmirësuar ajrin, reduktuar djegjen e thëngjillit e drunjve**, dhe për të siguruar **një jetë më cilësore** për qytetarët e Kryeqytetit, **kemi zgjeruar rrjetin** e Termokosit për **40,000 qytetarë shtesë**. Kemi nënshkruar ndërtimin e pesë shkollave dhe tri të tjera në ndërtim e sipër, duke sjellë **numrin e shkollave të reja në tetë**. Këto shkolla do të ofrojnë **arsim më cilësor, kushte më të mira për arsimtarët e nxënësit dhe reduktim të numrit të nxënësve** në shkollat aktuale. Mbi të gjitha do të **lehtësojnë jetën e prindërve** të cilët tani duhet të vozisin disa herë nëpër Kryeqytet për të dërguar dhe marrë fëmijët e tyre nga shkolla. Me përfundimin e këtyre shkollave, pra, do të **reduktohet dukshëm edhe komunikacioni në Kryeqytet**.

Janë duke u dizajnuar disa projekte të mëdha të cilat do të transformojnë Kryeqytetin tonë tutje, si: ndërtimi i **sheshit të Prishtinës së Vjetër** që përfshin ndërtimin e tunelit në rrugët Agim Ramadani dhe Ibrahim Lutfiu; kjo do të lidhet edhe me **tregun e ri** duke krijuar një **hapsirë të re funksionale dhe të bukur**; transformimi ish ndërtesës së Gërmisë në **Sallë të Koncerteve dhe Muze të Artit**; ndërtimi i **sheshit Xhorxh Bush**. Të gjitha këto do t'i japin një pamje tërësisht të re Prishtinës tonë të dashur.

Qytetarët e Veternikut tanimë po marrin **shërbime shëndetësore në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Veternik**, një shërbim bazik i cili iu kishte munguar qytetarëve të kësaj zone. Më tutje, **Spitali i Prishtinës është duke u dizajnuar** dhe punët në ndërtimin e tij do të fillojnë në fund të vitit 2023. Fëmijët tanë tani kanë **më shumë terene sportive** të reja dhe të renovuara. Bujqit tanë janë **mbështetur me serra, makineri bujqësore e pagesa direkte** në formë të subvencioneve.

Këto janë vetëm disa prej projekteve të mëdha që kemi nisur e realizuar në gjashtëmuorin e parë të vitit 2023. Ne do të vazhdojmë punën tonë pandërprerë për **transformimin e Prishtinës sonë në një Kryeqytet praktik, të pastër dhe të përjetimeve**.

I juaji,

**Përparim Rama**

Kryetar i Kryeqytetit



# Prishtina për **INFRASTRUKTURËN**

“ Në vazhdim po paraqesim investimet që kemi bërë në 6 muajt e parë të vitit 2023 në infrastrukturën e Kryeqytetit!





- Në vitin 2023 i kemi nisur punimet në rrugën “Jim Xhema” (Rruga A). Ky projekt madhor infrastrukturor për kryeqytetin, do të lidhë Prishtinën e Re me Kalabrinë, duke i dhënë fund edhe kutërbimeve nga kanalizimi i hapur dhe me rrezikshmërisë për fëmijët. Rruga “Jim Xhema” do ta shkarkojë dukshëm ngarkesën e trafikut në kryeqytet. Punimet i kemi nisur njëkohësisht nga të dyja skajet e rrugës në projektin monumental 240 ditësh, duke sjellë një standard të ri në infrastrukturën e qytetit, me korsi të veçantë për autobusë, shtigje për biçikleta, qasje në rrugët anësore dhe ndërlidhje me Rrugën B.
- Kemi filluar asfaltimin e rruges “Nekibe Kelmendi”, një ndër rruget më të rëndësishme për zhvillimin e Prishtinës së Re.
- Prishtina po transformon sistemin e ngrohjes qendrore përmes energjisë diellore. Me partnerët tanë të KfW, nënshkruam Marrëveshjen e Veçantë për projektin më të madh në rajon – Solar 4 Kosovo. Nëpërmjet këtij projekti do të kontribuojmë në ngritjen e kapacitetit të sistemit ekzistues të furnizimit me ngrohje, i cili do të jetë më eficient, më i sigurt dhe më miqësor me ambientin. Falë këtij projekti, sistemi i ngrohjes në kryeqytet do të transformohet përmes energjisë solare, duke ndikuar kështu dukshëm në përmirësimin e cilësisë së ajrit.



- Ka filluar instalimi i sistemit të ngrohjes në lagjen “Lakrishtë” me një sipërfaqe prej 17500 metrash katrorë, nga e cila do të përfitojnë 230 familje.
- Kemi vazhduar fazat e radhës për projektimin e Unazës së Kryeqytetit, bazuar në Planin e Mobilitetit dhe Planin Zhvillimor Komunal. Eshte prezantuar plani i fizibilitetit dhe dizajni preliminar nga kompania daneze SWECO. Jemi në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për të siguruar mbarëvajtjen e proceseve nga të dy palët dhe për të filluar sa më parë me implementim të projektit.

## 250.000

Kemi vazhduar me punime për zgjerimin e rrjetit të ngrohjes në lagjen “Arbëria”. Deri tani janë instaluar mbi 3892 metra gyp dhe 40 nënstacione, të cilat do të furnizojnë një sipërfaqe prej 250.000 metra katrorë.

- Me Rektorin e ri të Universitetit të Prishtinës kemi nënshkruar kontratën e ndarjes së lokacionit për ndërtimin e objektit të ri të Fakultetit të Shkencave Matematikore - Natyrore dhe Fakultetit Ekonomik.
- Po e ndriçojmë kryeqytetin në çdo cep! Kemi filluar zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, pas një neglizhimi për një kohë shumë të gjatë. Projekti, i ndarë në 4 faza, përfshinë më shumë se 100 rrugë - të cilat nuk kanë pasur asnjëherë ndriçim publik.
- Zhvillimi industrial është thelbësor për zhvillimin ekonomik të çdo qyteti dhe për rritjen e cilësisë së jetës për qytetarët tanë. Në vazhdimësi po theksojmë rëndësinë e bashkëpunimit mes nivelit lokal, qendror dhe sektorit privat për miratimin e strategjisë së duhur të zhvillimit industrial të të gjithë vendit. Ne synojmë të tërheqim investitorë duke krijuar politika mbështetëse dhe duke ofruar mjedis të favorshëm për ta. Konkretisht, këtë po e bëjmë nëpërmjet projektit të Zonës Industriale, i cili tanimë është në procesin e finalizimit.
- Kemi përfunduar asfaltimin e rrugës tek Stacioni i Autobusëve. Si rrugë lidhëse mes Kallabrisë e Dardanisë, po ndihmon dukshëm në lirinë e komunikacionit në këtë pjesë të kryeqytetit.

# 15

RRUGË E RRUGICA

## NË KODRËN E TRIMAVE, PËR HERË TË PARË U NDRIÇUAN 15 RRUGË E RRUGICA:

Rr. "Daniel Defo"; Rr. "Vlora"; Rr. "Kajë Selmani"; Rr. "Mustafë Sopi"; Rr. "Bernard Llupi"; Rr. "Hilmi Zariqi"; Rr. "Xhevat Begolli"; Rr. "Spiro Çomora"; Rr. "Lutfi Musiqi"; Rr. "Rahman Bahtiri"; Rr. "Isuf Pollomi"; Rr. "Rugova"; Rr. "Lulëzim Jashari"; Rr. "Xhevat Lleshi" dhe Rr. "Gjemil Fluku".

- Kemi filluar rikonstruktimin e rrugëve brenda zonës urbane, si rruga "Mine Peza" në lagjen Arbëria.
- Kemi filluar ndërtimin e rrugëve në fshatin Shkabaj. Rrugët si Rruga "Agron Rama"; Rruga "Eva Mbrendli"; Rruga "Bedri Dedja" dhe Rruga "Zejnullah Hahili", janë investime të tjera drejt transformimit të infrastrukturës rrugore në kryeqytet. Rrugët e reja sigurojnë lidhje të mirëfillta, të sigurta dhe ndihmojnë në zvogëlimin e trafikut nëpër rrugët aktuale të ngarkuara.
- Me ndermarrjen "Ibër Lepenci" nënshkruam Memorandumin e Mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit "Ndërtimi dhe zgjerimi i kapaciteteve për ujitjen e tokave bujqësore". Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi është ngritja e kapaciteteve të ujitjes, për-



katësisht rivitalizimi i disa pjesëve të sistemit të ujitjes. Ky projekt po krijon mundësi për rritjen e qëndrueshme të sektorit bujqësor, duke sjellë përfitime për komunitetin dhe ekonominë vendore.

- Vetëm në muajin Maj të vitit 2023 kemi filluar/përfunduar këto rrugë: rruga në fshatin "Zllatar"; rruga në lagjen "Kullaj" të fshatit Mramor; Rruga e re në fshatin "Butovc"; shtresa finale në Rrugen "Nekibe Kelmendi"; rruga e re në fshatin "Koliq"; rruga e re në fshatin "Prapashticë"; dhe rruga "Qëndresa" në Matiçan;
- Kemi filluar ndërtimin e disa rrugëve në fshatin Shkabaj: rrugen "Agron Rama"; Rrugen "Eva Mbrendli"; Rrugen "Bedri Dedja" dhe Rrugen "Zejnullah Hahili";
- Kemi filluar punimet në ndërtimin e rrugës e cila do ta lehtësojë komunikacionin në lagjen Arbëria. Kjo rrugë do të shfrytëzohet si tranzit për kalimin e veturave, nga rruga "Ahmet Krasniqi" në lagjen e "Arbërisë së Re", tek objektet e reja banesore.

- Po ndertohet rruga që lidhë fshatrat e Gollakut me Dardanën, nëpërmjet rrugës Viti - Bullaj. Po ndertohet rruga në lagjen “Gërbeshi” dhe rruga “Gjergj Balsha” në lagjen “Arbëria”. Rruga që lidhë fshatrat e Gollakut, Stallovë-Zllash.
- Ngrohtorja e qytetit ka vazhduar punimet me intensitet të lartë. Kemi bere planin per te kycur ne sistem 30 objekte te reja, me gjithsej 1150 apartamente të kompleksit “Banesat e Bardha” në lagjen «Bregu i Diellit». Ky projekt do të rezultojë me kursim të energjisë elektrike dhe do të ndikojë në përmirësim të cilesise se ajrit. Ne do të kujdesemi që ky projekt të përfundojë vitin e ardhshëm.

## “ MATI 1

Kemi filluar punimet në rrugicat/krahët e rrugës “Muharrem Fejza”, në lagjen Mati 1, në kryeqytet. Në rrugët “Ahmet Gashi”, e “Muhamet Qami” po bëhen instalimet e nevojshme nëntokësore dhe më pas do të asfaltohen të gjitha keto rruge e rrugica.

- Në fshatin Shkabaj po punohet me intensitet të lartë në përfundimin e ndërtimit të krahëve të rrugëve “Agron Rama”, “Eva Mbrendli”, “Bedri Dedja” dhe “Zejnullah Halili”, duke përfshirë kanalizimin fekal, atmosferik, ndriçimin, sinjalizimin vertikal dhe horizontal. Këto rrugë shërbejnë si qarkore për të hyrë në Prishtinë, përmes lagjes Arbëria dhe Kodrës së Trimave.
- Kemi filluar punimet në vazhdimin e ndërtimit të Rrugës “B” në pjesën e poshtme të saj. Rruga është e gjatë 390 metra dhe do të bëjë lidhjen e Rrugës “Jim Xhema” deri tek rrethi i Rrugës “B”. Ky projekt përmban: rrugën, ujësjellësin, kanalizimin fekal, kanalizimin atmosferik, ndriçimin dhe sinjalizimin.
- Është asfaltuar edhe një rrugë në fshatin Bardhosh, rruga “Gonxhe Bojaxhiu”.
- Pas një pune fantastike në teren kemi finalizuar punimet tek “Rrethi i Flamurit” dhe tek “Rrethi i Hyjneshës”. Për t’i memorizuar dhe funksionalizuar hapësirat përkatëse, u vendosën flamuri i ri dhe statuja e Hyjneshës në fron. Është rindërtuar komplet rrjeti i ndriçimit te mencur dhe shenjëzimi horizontal. Në të dy hapësirat, jemi kujdesur për te gjithë infrastrukturen përcjellëse.

- Kemi punuar ne rrugen e cila lidhë fshatin Marec me Artanën e Dardanën, rruga tashmë ka filluar të asfaltohet.
- Ne fshatin Zllatar nisëm me asfaltimin e rrugës dhe trajtimin e kolektorit atmosferik.
- Kemi filluar me punë në ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës “Mallakstra”, e cila do të bëjë lidhjen e fshatrave Bardhosh – Prugovc – Barilevë. Realizimi i këtij projekti do të bëjë të mundur qasjen shumë më të lehtë të banorëve të tre fshatrave me Prishtinën, do të shkurtojë rrugën për kryeqytet me rreth 7 kilometra.
- Kemi nisur punimet në ndërtimin e kolektorit në lagjen “Kalabria”, një nga projektet më të rëndësishme për banorët e kësaj zone. Me këtë projekt po i japim fund pritjes shumëvjeçare të banorëve për eliminimin e kundërmimit në këtë lagje. Përveç kësaj sipas planit dinamik kolektori do të lidhet në një afat të shkurtër me anën tjetër të rrugës “Jim Xhema”.
- Kemi zgjidhur problemet teknike që kanë hasur në terren dhe do të vazhdojnë me realizimin e planit dinamik. Gjatë ditëve në vijim do të jem në punishte për të parë ecurinë e projekteve. Në rast të parregullësive do të ketë penalizime e konfiskime të garancioneve bankare për operatorët ekonomik të cilët po ashtu nuk i përfillin afatet e caktuara.

■ Po vazhdojmë me zgjerimin e rrjetit të ngrohjes! Plus 20000 m<sup>2</sup> dhe 228 njësi banesore te reja te kycura ne ngrohtore. Të vetëdijshëm për nevojën që rrjeti i ngrohjes të zgjerohet sa më shumë, jemi duke analizuar të gjitha kapacitetet ekzistuese, për zgjerim të mëtutjeshëm! Zgjerim gjate veres, sherbim gjate dimrit.

- Po asfaltohen rrugët “Alush Hoti” dhe “Hazir Haxholli” në Shkabaj. Kjo lagje shërben si qarkore për të hyrë në Prishtinë. Kemi trajtuar edhe shtresën finale te asfaltit.
- Fshati Rimanishtë ka një bukuri natyrore të veçantë, por deri tani rrjeti i kanalizimit fekal ka qenë i patrajtuar dhe ka shkaktuar kundërmim të erës. Që të evitohen këto, kemi kontraktuar trajtimin e kanalizimit me mbi 10 km rrjet, ku do të përfshihen shtëpitë, ndërsa kundërmimit të erës do t’i vie fundi.
- Kemi filluar punimet në rrugën “Antigona Fazliu” pranë ShFMU “Pjetër Bogdani”. Ne kete pjese te qytetit, nga 1 shtatori fillojnë punimet edhe në rrugët “Mbreti Bardhyl” e “Maliq Pashë Gjinolli”.

- Jemi duke asfaltuar parkin-  
gun në Lagjen “Arbëria”, apo  
siç e njohim ne, Parkingu i “2  
Korrikut”. Kjo hapësirë do  
te ndihmoj shumë fushen e  
sportit, por edhe banoret e  
lagjes.
- Jemi duke asfaltuar rrugën  
“Skenderbeu”, pjesa e parë  
e së cilës në gjatësi 700m.  
Fazën e dytë të kësaj rruge e  
vazhdojmë me kapacitet të  
plotë duke e trajtuar rrjetin  
e kanalizimit fekal, ndërsa  
gjate kësaj kohe do ta traj-  
tojmë edhe rrjetin e ujit me  
kyçjet e shtëpive.
- Kemi ndriçuar për herë të  
parë rrugën kryesore, bash-  
kë me rrugët ndërlidhëse  
të lagjes “Ulpiana e Re” në  
Hajvali.
- Pas më shumë se 40 vjetësh  
shkallët te “Posta e Madhe”  
kanë marrë pamje tjetër,  
janë renovuar tërësisht, e  
shumë shpejt do të ven-  
doset ashensori për t’ua  
mundësuar qasjen per-  
sonave me nevoja të veçan-  
ta dhe nënave me karrocë  
fëmijësh. Kemi shtuar gjel-  
bërmin dhe e kemi ndriçuar  
gjithë zonën.



- Për herë të parë në Kryeqytet, do të kemi biçikleta publike. Kemi nënshkruar kontratën për blerjen e bicikletave publike, të cilat do të përdoren nga qytetaret e Prishtinës, por edhe nga vizitorët e shumtë në Kryeqytet.
- Po vazhdojmë me sinjalistikë, shenjzim dhe implementim të elementeve të sigurisë në zonat rurale, me qëllim që çdo pjesëmarrës në komunikacion të jetë i sigurt. Çdo ditë, ekipet tona po punojnë në zgjerimin e ndriçimit publik në Kryeqytet. Kemi punuar në zgjerimin e rrjetit në lagjet Velani, Sofali, Kodra e Tirmave, Qëndresa në Veternik dhe po ashtu në fshatin Shkabaj.

**Ekipet tona, bashkë me ndërmarrjen “Hortikultura”, po kujdesen që të pastrohen rrugët dhe të bëhet mirëmbajtja e vegetacionit përgjatë brezit rrugor, me qëllim që të rritet siguria dhe çdo shenjë e komunikacionit të ketë vizibilitet.**

- Me Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, kemi arritur marrëveshje për renovimin e fontanës, një ikone e qytetit tonë.



- Ka filluar implementimi i infrastrukturës së ndriçimit te mencur, në unazën qendrore të kryeqytetit.
- Rrugët periferike dhe ato rurale të Kryeqytetit, po mirëmbahen si asnjëherë më parë. Rreshjet e shiut, shembjet e dheut kanë qenë disa nga sfidat që kishim në këto zona, por me punën e palodhshme dhe profesionale të ekipit, kemi arritë t'i mbajmë ato rrugë të kalueshme dhe të mirëmbajtura.
- Kemi vazhduar me pastrimin e shtratit të lumit Llap.
- Kemi përfunduar regjistrimin e njësive banuese në Kryeqytet, duke e përmbushur pikën e parë të Master Planit të Menaxhimit të Mbeturinave. Po ashtu në të njëjtën kohë nga ekipi i Sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave në kuadër të DSHP-së është përfunduar Rregullorja e Menaxhimit të Mbeturinave, ku me këtë rast kemi përmbushur edhe pikën e dytë të Master Planit. Ne muajt në vazhdim, do të shpallim thirrjet për implementimin e pikave tjera të Master Planit dhe deri në fund të këtij viti do të përmbushim të gjitha pikat.

## “ FLOTA E RE ME AUTOBUS

Bashkë me BERZH-in, jemi kujdesur që për herë të parë sektori privat të involvohet mire në transportin e Kryeqytetit, të trajtohet me dinjitet e të bëhet pjesë e reformimit dhe vizionit të Kryeqytetit për transportin publik. Aktivitetet në vazhdim janë ri-organizimi i linjave, shtimi i linjave të reja në çdo cep të Kryeqytetit, flota e re me autobus për Trafikun Urban dhe flota e re me autobus për sektorin privat.

- Po vazhdon vendosja e pritoreve në Kryeqytet. Ato janë me moderne, digjitale dhe kanë qasje dhe hapësirë për personat me nevoja të veçanta. Kane më shumë hapësirë për udhëtarët dhe janë me elegante.

29

**Jemi kujdesur për vendosjen e 29 shportave të reja në sheshin e Kryeqytetit.**

- Në lagjen e madhe të Kryeqytetit “Qëndresa” kemi vendosur ndricimin pulik. Rruget “Bajram Kurti”; rruga “Da Vinqi”; rruga “Shemso Ferri”; dhe rruga “Sefedin Vitia”.





# Prishtina për **SPORTIN**

“ Në vazhdim po paraqesim investimet që kemi bërë në 6 muajt e parë të vitit 2023 në infrastrukturën sportive të Kryeqytetit!



AMSTERDAM	EX3 FINAL	FREIBURG
01	09:17	00
FOULS 1		FOULS 0

Wilson.

Wilson.




- Gjatë kësaj periudhe kohore kemi nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në mes Kryeqytetit dhe Federatës së Futbollit të Kosovës, në mënyrë që bashkërisht të vazhdojmë mirëmbajtjen dhe investimet në stadiumin e futbollit “Fadil Vokrri”. Gjatë takimit biseduam edhe për bashkëfinancimin e Stadiumit të ri të Kryeqytetit në Bërnice.
- Së bashku me Kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës kemi vizituar Stadiumin Olimpik në Stamboll, dhe disa ndërtesa të tjera të rëndësishme. Eksploruam mundësitë dhe idetë që Stadiumi i Ri i Kryeqytetit i cili do të ndërtohet në Kampusin e Sporteve në Bërnice dhe Poshtme, të jetë i kategorisë katë të UEFA. Ky Stadium do të jetë në shërbim të ekipeve kombëtare dhe të Kryeqytetit. Ky stadium do të ketë rëndësi të veçantë në avancimin e kushteve të futbollit në Kryeqytet dhe në Kosovë në përgjithësi. Gjithashtu, u pajtuam që Federata e Futbollit të Kosovës të ketë përgjegjësinë për menaxhimin e stadiumit të ri, sipas modaliteteve ekzistuese që vlejné për stadiumin “Fadil Vokrri”.
- Kemi ndërtuar dy kënde të reja lodrash në kryeqytet, të cilat i përruam bashkë me nxënës nga Shkolla Filllore “Faik Konica”. Përveç lodrave, kemi përfshirë edhe pajisje fitnesi për të promovuar një mënyrë jetese të shëndetshme.

## PISHINËS E GËRMISË

Pas 10 vjetësh, kemi investuar në pishinën së Gërmisë për të ia kthyer freskine. Pishina, sot ka një ambient të ri: guaskë të lye, investime në amfiteatër dhe në terrenin sportiv, renovim të tualeteve, shtretër për relaks, gjelbërim të shtuar, si dhe kënd të ushqimit dhe aktivitete të shumta artistike për të gjitha grupmoshat.

- Kemi lansuar projektin për fuqizimin e vajzave. Nisma për ngritjen e ekipeve të vajzave në qytetin tonë është një hap i rëndësishëm drejt promovimit të barazisë gjinore dhe thyerjes së barrierave e stereotipeve. Po jetësohet edhe një prej synimeve të rëndësishme të qeverisjes sonë lokale - themelimi i ekipeve të për vajza në shkollat e Prishtinës. Kryeqyteti është bërë partner strategjik i KFV “Prishtina”. Kemi lansuar kampanjen e krijimit të ekipeve zyrtare të vajzave në çdo shkollë të Prishtinës, organizimit të kampeve verore dhe ‘Ligave Shkollore’; ngritjes së kapaciteteve dhe vetëdijësimin, dhe do të bashkëpunojmë ngushtë me UEFA Foundation for Children - financues të projektit për fuqizimin dhe përfshirjen e vajzave në futboll.
- Kemi mbështetur Turneun Ndërkombëtar të Pingpongut “PRISHTINA OPEN 2023”. Në bashkëpunim me Klubin e Pingpongut «Priping» organizuam Turneun Ndërkombëtar të Pingpongut. Garuan mbi 150 pjesëmarrës nga 10 shtete të ndryshme të botës në kategoritë Junior, Senior dhe veteranë për dy



gjinitë. Për me teper, kemi mbeshtetur garat ndërkombëtare në basketboll 3X3, te cilat u mbajten në sheshin “Zahir Pajaziti”. Për katër ditë, basketbollistë e basketbolliste nga 14 shtete të ndryshme të botës, shfaqën talentet e tyre në këtë sport duke na dhuruar emocione dhe duke krijuar atmosferë të jashtëzakonshme në #kryeqytet. Jemi të përkushtuar të krijojmë infrastrukturë sa më të përshtatshme për zhvillimin e garave të tilla ndërkombëtare, duke ndërtuar fusha e salla të reja të sportit ne do të mundësojmë që rinia jonë e cila është thesari i vendit tonë, të shfaqin talentet e tyre e të njihen edhe më shumë ndërkombëtarisht.

- Kemi renovuar dhe transformuar fushën e jashtme sportive në lagjen Dardania, me saktësisht tek shkolla SHFMU “Dardania”. Gjithashtu, kemi renovuar dhe transformuar dy fusha të jashtme sportive në lagjen Kodra e Trimave. Fusha e parë do t’i dedikohet futbollit dhe hendbollit, ndërsa fusha tjetër do të shërbejë si një fushë ideale për basketboll në një kosh. Por, kjo nuk është e tëra, kemi në plan që të shtojmë edhe një fitnes të jashtëm dhe një hapsirë të veçantë për kënd lodrash për fëmijë ne kete pjese.

**Kemi filluar renovimin dhe transformimin e fushës së jashtme sportive në shkollën “Ismail Qemali”, në Bregun e Diellit, ku do te kete hapsirë sportive që do t’i shërbej nxënësve dhe komunitetit të lagjës, për aktivitete futbollit, basketbollit, volejbollit, hendbollit, vrapime dhe ushtrime të ndryshme.**

- Kemi ndërtuar fushën e jashtme sportive ne lagjen “Vreshta”.
- Kemi filluar punimet për renovimin dhe transformimin e fushës së jashtme sportive në Parkun e Gërmisë.
- Parku atraktiv i sportit dhe rekreacionit në fshatin “Prugoc” është në fazën përfundimtare të punimeve dhe intervenimeve, dhe shumë shpejt do të jetë në dispozicionin e banoreve te asaj pjese.
- Fusha e jashtme e sportit në lagjen “Velania” do të renovohet dhe transformohet në një ambient të shkëlqyeshëm për aktivitete sportive.
- Kemi mbeshtetur turneun “PRISHTINA OPEN 2023”, i cili u organizua nga Klubi i Karatesë “Prishtina” Prishtinë. Ka pasur sukses të madh dhe do të jetë një kujtim i paharrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bujanoci dhe klubet e shumëta nga Kosova. Me mbi 412 garues, Pallati i Rinisë dhe Sporteve ka ndjekur



një atmosferë të jashtëzakonshme, duke krijuar një ambient të veçantë për lojërat dhe përballjet sportive. Pjesëmarrja e numrit të madh të garuesve tregon interesin dhe përkushtimin e tyre ndaj këtij turneu.

- Kemi renovuar dhe transformuar fushën e jashtme te sportit ne lagjen Dardania tek “Kroni i Bardhë”. Kjo është një arritje e madhe që kontribuon në përmirësimin e infrastrukturës sportive në komunitetin tonë. Fusha e rinovuar do të ofrojë mundësi të reja për aktivitete sportive, argëtim dhe shëndet.

- Kemi filluar renovimin e shtegut për ecje dhe vrapim në lagjen “Taukbaqë”.
- Fusha e jashtme sportive në lagjen “Ulpiana” është renovuar dhe transformuar falë donacionit nga kompania Optima Energy Consulting, në bashkëpunim me Drejtorinë për Sport. Tani, kjo fushë është e gatshme për qytetarët e lagjes, por edhe për banorët e kryeqytetit.

Renovimi i fushës së jashtme sportive ka ndodhur në mënyrë profesionale dhe ka rezultuar në një pamje tërheqëse dhe cilësore.

- Po punohët intensivisht në tribunën lindore të FC “2 Korriku”, në një ndër klubet më të vjetra në Prishtinë, që konsiderohet çerdhe e talentëve të jashtëzakonshëm. Qysh në fillim të mandatit – jemi zotuar se do të mbështesim klubet tona sportive në të gjitha format – në misionin për ta shëndërruar Prishtinën qytet të SPORTIT.

“

Kemi filluar ndertimin e nje fushe për STREETBALL në parkun e TaukBahqes. Pas shumë kërkesave nga banorët e lagjës së TaukBahqes, posaqërisht të rinjtë e talentuar të saj, filluam me ndërtimin e fushës speciale për Streetball. Bashkë, do të kombinojmë natyrën, sportin dhe ambiciet e rinisë tonë të mrekullueshme, për t’u dhënë platformë moderne në realizimin e ëndrrave të tyre. Fusha do të ketë material nga goma, e hapur për të gjithë, dhe do të jetë në harmoni me ambientin e mrekullueshëm që e rrethon.

- Kemi përruar këndin e lojërave dhe fitnesin e ri të jashtëm në Lagjen e bukur Dardania. E kam thënë në fillim, promovimi i aktiviteteve sportive për të gjitha moshat dhe në secilën lagje të Kryeqytetit, do të jetë synim i joni gjatë këtij mandati. Ky park dhe ky fitnes është në shërbim të këtij vizioni, për të ta bërë Prishtinën qytet të sportit. Më shumë kënde lojërash dhe më shumë fitnese do të përrohen gjatë këtij viti edhe në lagje e fshatra të ndryshëm të Prishtinës, krahas investimeve tjera kapitale të cilat do t’i realizojmë për klubet tona.
- Lagjja Lakrishte u bë me kënd të ri të fitnesit dhe së shpejti do ti renovohet edhe fusha e jashtme e sportit.





# Prishtina për **KULTURËN**

“ Në vazhdim po paraqesim mbështetjen dhe investimet që kemi bere ne 6 muajt e pare te vitit 2023 per kulturen ne Kryeqytet!





- Kemi mbeshtetur koncertin e orkestrës së Filharmonisë së Kosovës, me program festiv dhe një performancë fantastike nga Sihana Badivuku - violinistja e mirënjohur, e cila me interpretimin e saj të shkëlqyer vulosi fuqishëm përmbylljen e një viti, ku arti dhe kultura ishin në qendër të vëmendjes së kryeqytetit.

“

## “MORCHEEBA”

Me rastin e 15 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës tonë, kemi organizuar koncertin festiv me bendin e mirënjohur britanik “Morcheeba”. Koncerti u organizua në sallën e sporteve të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve. Para “Morcheeba” kishim kënaqësinë me përjetu performancën e artistëve tonë të Prishtinës, Shpat Deda e La Fazani me bendet e tyre.



- Kemi mbeshtetur edicionin e radhes te Chopin Piano Fest. Nën tingujt magjik të pianistit të mrekullueshëm italian, Epifanio Comis dhe Adra Strings, u hap edicioni i 13-të i festivalit të muzikës klasike Chopin Piano Fest Prishtina. Për 13 vite rradhazi, Chopin Piano Fest ka sjellë artistë të shquar nga mbarë bota. Jemi tejet mirënjohës organizatorëve për vlerat kulturore që i kanë sjellë Kryeqytetit.
- Kemi mbeshtetur edicionin e 11-të të FemArt “Kalle Tutën” në Teatri Kombëtar i Kosovës. Prishtina është shtëpia e një skene të larmishme dhe të gjallë feministe, me njerëz kreativë që na inkurajojnë të përpiqemi vazhdimisht për marrëdhënie më autentike në mbarë shoqërinë dhe na shtojnë të punojmë drejt drejtësisë, barazisë dhe sigurisë publike; duke avokuar për hapësira gjithëpërfshirëse, përkrahëse dhe të guximshme, që u mundësojnë individëve të shihen, të afirmohen dhe të çmohen. Më shumë se kurrë, ne e pohojmë mbështetjen tonë për praninë e këtyre krijuesve, të cilët, me dashuri dhe përkushtim ua ngjallin kurajon dhe fuqinë zërave që dridhen për ta kallë tutën. Tash 11 vjet organizatorja Zana Hoxha sjell talente ndërkombëtare dhe vendore në Kosovë, duke ndërthurë një program të mirëmenduar mbi përvojat e grave dhe të vajzave nga e gjithë bota.

- Kemi mbështetur organizimin e Festivalit të Pranveres. Festivali është mbajtur në datat 2, 3 dhe 4 Qershor, në sheshin “Xhorxh Bush”. Ky festival është një mundësi e shkëlqyeshme për të takuar, komunikuar dhe festuar së bashku, duke krijuar një atmosferë pozitive dhe argëtuese. Ambienti i këtij festivali është i pasur me kreativitet, me performanca muzikore dhe artistike. Në të njëjtën kohë, ka hapësira të dedikuara për rekreacion, ku qytetarët kanë pasur mundësinë të relaksohen dhe të shijojnë momente të këndshme.

## PANAIRIN E LIBRIT 2023

- Kemi mbështetur PANAIRIN E LIBRIT 2023 në Prishtinë. Panari sjell bashkë autorë, botues dhe lexues në një ambient frymëzues, duke krijuar një platformë të shkëlqyeshme për përhapjen e dijes. Përmes panairit, promovohet një kulturë e leximit dhe edukimit që i pasuron mendjet e individëve dhe komunitetit në tërësi. Panairi është organizuar në datat 6-11 qershor, në Pallatin e Rinisë.
- Kemi mbështetur organizimin e Festivalit “Festat e Korrikut”. Përmes performancës nga Grupi “Jericho” përplotë me kryeqytetas u dëfryem dhe mbushëm rrugën e re “2 korriku” të dedikuar për argëtim në qendër të qytetit. kryeqytetit po i shtohen hapësirat rekreative dhe po përmisojmë jetën kulturore në kryeqytet. Rruga “2 korriku” do të jetë vetëm një nga shumë hapësirat në të cilat do të intervenojmë duke zgjeruar diametrin kulturor në Kryeqytet.
- Salla e Kuqe në Pallatin e Rinisë shumë shpejtë do të rinovohet. Kemi konstatuar domosdoshmërinë për rinovimin e kësaj sale, e cila është pothuajse e vetmja adresë për artistët tanë për të zhvilluar aktivitetet e tyre. Në këtë mënyrë iu ofrojmë qytetarëve dhe artistëve tanë kushte adekuate dhe një standard në salla koncertale si kjo.

**Kemi mbështetur “Prishtina Gastronomy Festival”. Gjithë vera do të jetë plot me festivale e aktivitete kulturore për të gjithë qytetarët e Prishtinës.**



- Kemi mbështetur “Rame Lahaj Opera Festival”. Mbrëmja e së dielës, në koncertin gala të RLOF, do të mbetet një natë e paharrueshme për të gjithë ne që ishim prezent në sheshin “Skënderbeu”, për të dëgjuar zëra të jashtëzakonshëm, e në veçanti të tenorit tonë me famë botërore, Rame Lahaj. Dirigjent, tenor, soprano e bariton, të cilët gjithë bota i do, na i solli midis qendrës së Prishtinës, Rame Lahaj, tenori ynë i cili po bënë një punë të jashtëzakonshme në zbulimin e talenteve të rinj, e po vë Kosovën në hartën botërore të kulturës e muzikës. I jemi mirënjohës për angazhimin e tij.

- Kemi mbështetur “Meeting of Styles”, festivalin e grafitëve në “Rruga “B”, i cili festival po gjallërohet me ngjyrat e shumta nga grafitet e muralet e bukura të artistëve nga vende të ndryshme të botës, të cilët po krijojnë në muret përgjatë rrugës, në kuadër të Meeting of Styles Kosovo.







# Prishtina për **PARQET DHE HAPESIRAT PUBLIKE**

“ Në vazhdim po paraqesim investimet që kemi bërë në 6 muajt e parë të vitit 2023 në infrastrukturën e gjelbërt të Kryeqytetit!





- Kryeqytetit i shtohen dy kënde lodrash të qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Faleminderit partnerëve tanë OSCE Mission in Kosovo dhe YARL-Youth are the real leaders, për realizimin e këtij projekti shumë të nevojshëm. Qasja e barabartë për të gjithë qytetarët është prioritet i yni! Jemi në hapat e duhur drejt nje Prishtine për të gjithë.

## “KODRA E TRIMAVE”

Kemi punuar ne parkun e ri rekreativ në “Kodrën e Trimave”, tashme ka përfunduar dhe është në dispozicion të banorëve dhe fëmijëve të lagjes. Ky është një hap i rëndësishëm drejt një komuniteti më të qetë, dhe më të ndërgjegjshëm për mjedisin. Ky është vetëm një ndër projektet e shumta në kuadër të rigjenerimit të lagjes Kodra e Trimave.



- I nisëm punimet për ndërtimin e parkut në rrugën “Sylejman Vokshi”. Ky park do të jetë pikë takimi për qytetarët e lagjes, dhe jo vetëm. Do të përqafojë të gjitha moshat pa dallim, duke ofruar hapësirë për ecje, hapësirë me ulëse për shoqërim e pushim dhe këndin e lojrave për fëmijë. Po ashtu do të gjelbërohet me pemë të reja e të bukura që janë të dobishme për pastrimin e ajrit dhe krijimin e hijes. Një hapësirë të pashfrytëzuar, po i shtohet gjelbërimi dhe po ju kthehet qytetarëve në shfrytëzim.

**Hyrja e Prishtinës është shndërruar në një vend të gjelbër, me një pamje të re, duke shfaqur një dizajn të mrekullueshëm. Në një përpjekje për të rritur biodiversitetin, ne kemi kuruar me kujdes një përzgjedhje të shkurreve dhe drunjëve me gjelbërim gjethëmbajtës.**

- Në parkun “Agushi” ne Prishtinë, u prezantua vizioni për krijimin dhe ndërtimin e “Tregut të Gjelbër” në zonën e vjetër të qytetit. Kryeqyteti ynë ka planifikuar krijimin e një tregu që plotëson të gjitha kushtet e nevojshme infrastrukturore, duke përfshirë në projekt edhe kërkesat e tregtarëve dhe banorëve të lagjes. Tregu pritet të hapet në vjeshtë të vitit 2023.



- Kemi larguar edhe një deponi mbeturinash nga kryeqyteti. Kemi mbyllur këtë zonë plotësisht të lënë pas dore deri më tash, tek SHM “Xhevdet Dosa”, për të mos lejuar hedhjen e mbeturinave më tutje. Poashtu, jemi duke shqyrtuar mundësinë për hapjen e një korsië të re që lidhet direkt me magjistralen Prishtinë - Fushë Kosovë.
- Po lirohen hapësirat publike të uzurpuara në kryeqytet. Kemi liruar hapësirën në afërsi të Stacionit të Trenit, në rrugën “Tirana”, e cila pas 20 vitesh u pastrua nga masiviteti i mbeturinave inerte të mbetura. Po shndërrojmë menjëherë këtë zonë në një hapsirë tjetër të gjelbëruar për kryeqytetin.
- Kemi vazhduar punimet, pas zgjidhjes së shumë problemeve, në rrugën “Dëshmorët e Ponoshecit”. Falenderim për Ndermarrjen “Iber Lepencin” për bashkëpunim si dhe banorët për qasjen dhe organizimin e mrekullueshëm që kanë.
- Kemi larguar deponitë ilegale dhe kemi filluar rivitalizimin e hapësirave publike, me qëllim që të mos përsëritet deponia e mbeturinave në hyrje të QKUK-së.





# Prishtina për **ARSIMIN**

“ Në vazhdim po paraqesim investimet që kemi bërë në 6 muajt e parë të vitit 2023 në infrastrukturën arsimore të Kryeqytetit!





- Përruam kabinetin e ri të TIK-ut në shkollën “Zenel Hajdini”. Kabineti është pajisur me tabelë interaktive (Smartboard), 18 kompjuterë të rinj profesional dhe të gjitha pajisjet përcjellëse. Faleminderit Qatar Charity për financimin e këtij projekti shumë të nevojshëm.

## “ PAISJA ME DOLLAPË

Kemi pajisur me dollape të fëmijëve, për klasët e para deri në klasët e pesta, shkollat “Hasan Prishtina”, “Ismail Qemali” dhe “Naim Frashëri”. Një hap tejet i rëndësishëm për të hequr barrën e çantave të rënda që rrezikojnë shëndetin e të vegjëlve tanë. Dalëngadalë shkollat e kryeqytetit po i shndërrojmë në ambiente më praktike e miqësore për të gjithë nxënësit tane.



- Kemi filluar punimet për ndërtimin e shkollës së mesme “7 shtatori”. Kemi nisur këtë projekt me shumë zell dhe entuziazëm. Jemi të lumtur që po bëjmë hapin e parë drejt realizimit të kësaj shkolle dhe presim me padurim ndikimin pozitiv që kjo shkolle do të ketë tek nxënësit tane.
- Kemi filluar ndërtimin e shkollës nëntëvjeçare në lagjen “Qëndresa”. Kjo shkolle do të ketë sipërfaqe prej 6.726 m<sup>2</sup>. Ky është projekt i shumëpritur prej banorëve të zonës, me impakt pozitiv zinxhiror, jo vetëm për prindërit, nxënësit dhe arsimtarët, por për të gjithë qytetarët e kryeqytetit. Ndërtimi i kësaj shkolle, si dhe i dy të tjerave në të ardhmen e afërt, me modalitetin publiko-privat, do ta lehtësojë dukshëm barrën aktuale të mësimdhënësve në klasat e stërbushura me nxënës, si dhe trafikun e ngarkuar prej lëvizjeve drejt qendrës së qytetit. Më pak stres për prindërit, arsimtarët e qytetarët. Më shumë cilësi e punësimi. Më shumë mundësi për një të ardhme më të ndritur për fëmijët tanë.
- Kemi nënshkruar marrëveshjen për ndërtimin edhe të pesë shkollave të reja në Kryeqytet. Së bashku me IFC - International Finance Corporation - nënshkruam marrëveshjen për nisjen e ndërtimit të pesë shkollave të reja për fëmijët tanë drejt një arsimit më cilësor.



Këto pese shkolla të reja do të ndërtohen në: lagjen Arbëria; lagjen Mati 1; lagjen Veternik; lagjen Kalabria; dhe ne Qendër. Brenda periudhës dy vjeçare do të ndërtojmë gjithësej 8 shkolla. Arsimit cilësor, kushte më të mira për arsimtarë dhe nxënës, më pak trafik dhe më shumë punësim, ky është vizioni ynë.

- Kemi dhuruar 15 bursa për studentët e dalluar të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike. Kryeqyteti do ta bëjë traditë dhënien e bursave për studentë të dalluar, sepse arsimi cilësor është çelsi për të zhbllokuar potencialin brenda çdo individi. I përgëzojmë studentët që janë përfitues të këtyre bursave dhe ju urojmë suksese në rrugëtimin e tyre drejt dijes.
- Gjate këtyre 6 muajve të pare kemi vazhduar ndërtimin e shkollës fillore “Nëna Terezë” në fshatin “Vranidoll”.
- Kemi filluar punimet për ndërtimin e aneksit të shkollës “Pavarësia” në rrugën “Muharrem Fejza”. Me 12 klasa të reja dhe 3 kabinete në aneksin e ri, kjo shkollë, e vetmja aktualisht në Kryeqytet, nuk do ta ketë më të nevojshme të punojë në tre ndërrime, shkaku i mbing-

arkesës me nxënës. Siç e kemi thënë në takimet me banorët e lagjes, ky aneks i shumëpritur ka qenë prioriteti ynë nga fillimi.

- Përmirësimi i kushteve në shkollat dhe çerdhet e kryeqytetit ka qenë prioritet i yni prej ditës së parë, prandaj jemi krenarë që riparimet në to po kryhen çdo ditë! Tashmë, shkollat dhe çerdhet do të kenë në dispozicion edhe “Mjeshtrin e Shkollës” - një ekip mobil i yni, i cili do të jetë i disponueshëm 24/7 për të gjitha rregullimet që shkollave dhe çerdheve mund t’u nevojiten. Sepse ambientet me kushte cilësore për edukimin e fëmijëve tanë janë gjithmonë prioritet.
- Nxënësit e fshatit Vranidoll gjysmë-vjetorin e parë të vitit të ri shkollor do ta presin në objektin e ri të shkollës, i cili është duke u ndërtuar me ritme të shpejta. Një ndërtesë e re me kushte shumë më të mira infrastrukturore do të jetë shtëpia e dytë për shumë nxënës të zonës, e cila do t’i pres me shumë ngrohtësi.
- Një ndër shkollat më ikonike të Prishtinës, Shkolla Fillore “Dardania” po renovohet tërësisht. Renovimi që do të zgjasë deri në mars të vitit tjetër do ta transformojë shkollën në një objekt modern, eficient e miqësor.
- Në çerdhen e re, në lagjen “Pejton”, që është afër kompletimit, kemi filluar instalimin e ngrohjes me Termokos.

Punët në renovimin e shkollës SHFMU “Naim Frashëri” - Prishtinë po vazhdojnë. Si një prej shkollave më të vjetra të Prishtinës, shkolla “Naim Frashëri” ka pasë nevojë për renovim rrënjësor. Në çdo vizitë e takim me prindër, nxënës e mësues të shkollës kemi parë nevojën e madhe për modernizim të shkollës. Dhe kështu po bëjmë, që shtatori i këtij viti të na gjejë me shkollë ma funksionale e moderne që na inspiron për të nxënë dije të reja.

- Po e rregullojmë fushën e jashtme sportive në shkollën fillore “Gjergj Fishta” në Prishtinë. Fëmijët e lagjes dhe të shkollës shumë shpejtë do të luajnë futboll e basket në fushën e re.
- Po vazhdojnë punimet në ndërtimin e shkollës së re të tregtisë, hotelierisë dhe turizmit “7 Shtatori”. Objekti i ri do të jetë modern dhe do të ketë restaurant për punë praktike, rreth 4000m<sup>2</sup>, sallë të sportit dhe ambiente miqësore.

- Punimet ne objektin e ri te çerdhes “Xixëllonjat” tregojnë që po punohet me dinamikë të shtuar. Prishtina ka nevojë për më shumë shkolla e çerdhe dhe po punojmë çdo ditë të bëjmë ndryshime pozitive.
- Kemi filluar ndërtimin e aneksit të SHFMU “Pavarësia” ne Prishtinë, ne menyre që shkolla t’i kthehet normalitetit e të mos punoj më me tre ndërrime. Lajm i mirë për nxënësit, prindërit dhe të gjithë mësimdhenësit e shkollës.
- Filluam renovimet sezonale në shkollën e mesme “Hoxhë Kadri Prishtina”. E lënë anash për vite me radhë, kjo shkollë shtatorin e ketij viti do ta pres me ndryshime drastike. Renovim i përgjithshëm i nyjeve sanitare, dyerve e dritareve, dyshemeve, mureve e kabineteve. Të gjitha këndet tejet të dëmtuara të shkollës do të renovohen plotësisht. Në shtator, ambienti në shkollë do të jetë me miqësor e me praktik.
- Kemi ndare parcelat tokesore për ndërtimin e dy çerdheve në fshatërat “Busi” dhe “Llukar”. Përfshirja sa më e madhe e fëmijëve në edukim të hershëm do të ndikojë pozitivisht edhe në rritjen e numrit të grave në tregun e punës, përpos që ka benefite afatgjate për zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve.

## 1.5 mil. EUR

Kemi ndare 1.5 mil. EUR në vit për siguri në shkolla. Kemi hartuar Planin e Veprimit për Siguri në Shkolla 2023-2026. Një vit punë për të bërë një plan që i përfshinë disa prej aktiviteteve kryesore që rrisin sigurinë në shkollat e Prishtinës. Plani përfshinë investime në infrastrukturë për rritjen e sigurisë fizike (shënjëzim, kamera, rrethoja, plan për emergjenca, aktivitete në përmirësim të klimës në shkollë (psikologët shkollorë, fushata kundër bullizmit dhe fenomeneve negative, krijimi i ekipit të sigurisë dhe mirëqenies në shkolla dhe DKA) si dhe investime në rritjen e sigurisë nga shkolla në shtëpi dhe anasjelltas (inspektime të lokaleve afër shkollave, ndriçim publik, tansport të sigurtë).

- Lagjes Dardania më në fund po i shtohet një çerdhe e re. Më në fund, projekti i financuar nga BE për ndërtimin e çerdhes së re në lagjen Dardania po finalizohet. Punimet janë shumë afër përfundimit dhe ndërtimi që kishte filluar që nga viti 2016 po finalizohet. Çerdhja e re do të jetë moderne, me hapësira të këndshme për fëmijë dhe hapsira të mjaftueshme për lojë, aktivitete e mësim.

- Edhe një hap më afër digjitalizimit të shkollave të Prishtinës. Me projektin KODE te Ministrisë së Ekonomisë kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për shpërndarjen e rrjetit të internetit në të gjitha shkollat dhe çerdhet e Prishtinës. Interneti do të jetë i shpejtë, i qasshëm në çdo pjesë të shkollës, e mbi të gjitha i sigurt. Gjithashtu u pajtuam që të gjitha zgjidhjet digjitale të Prishtinës në arsim të hostohen në sistemin KREN të Ministrisë.

## 30000 EUR

Kemi dhuruar instrumente të reja muzikore për Shkollën e Muzikes “Prenk Jakova” ne Prishtinë, në vlerë prej mbi 30000 EUR. Pianino, violina, violoncello të reja që do të përforcojnë ushtrimet e nxënësve dhe do t’i ndihmojnë të arrijnë suksese të reja.

- Kemi përfunduar ndriçimin e jashtëm në Shkollën “Mehmet Gjevari” ne Prishtinë. Nuk do të ndalemi derisa asnjë shkollë e Prishtinës të mos jetë në terr! Renovuam edhe nyjet sanitare në shkollën fillore “Afrim Gashi” ne lagjen Hajvalia. Shkolla duhet të ketë ambiente miqësore e higjienike për nxënësit, prandaj, po investojmë në çdo shkollë që fëmijët e Prishtinës të ndihen të sigurtë.
- Bashke me organizaten “Save the Children” kemi hapur qendrën e parë të fëmijëve të moshës 3 deri në 5 vjeç në fshatin Barilevë. Kjo qendër, në ambientet e shkollës “Ali Kelmendi” do të ofrojë kujdes për fëmijët e Barilevës, të moshës 3 deri në 5 vjeç, duke zbatuar konceptin për kujdesin dhe zhvillimin gjatë fëmijërisë të hershme. Koncepti është gjithëpërfshirës, ku fëmijët do të socializohen mes vete dhe do të zhvillojnë aktivitete me edukatoren. Në të njëjtën kohë, prindërit do të kenë sesione informuese rreth shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve falë ndihmës nga Drejtoria e Mirëqenies dhe Drejtoria e Shëndetësisë.
- Përfundoi edhe ndriçimi i brendshëm në SHFMU “Pavarësia” Prishtinë. Shumë shpejtë do të fillojmë edhe ndërtimin e aneksit të kësaj shkolle të mbingarkuar të Prishtinës.
- Pas shumë njoftimeve nga këshilli i prindërve dhe shkolla, rregulluam ndriçimin e jashtëm në SHFMU “Xhavit Ahmeti” ne Prishtinë dhe SHFMU “Xhemail Mustafa” ne Prishtinë. Ndriçimin e brendshëm e përfunduam para dy javësh. Gjithashtu, pas shumë njoftimeve nga këshilli i prindërve dhe shkolla, rregulluam ndriçimin e brendshëm në SHFMU “Xhavit Ahmeti” Prishtinë. Gjatë javës do ta përfundojmë edhe ndriçimin e jashtëm.



# Prishtina për **SHËNDETËSINË**

**“ Në vazhdim po paraqesim investimet që kemi bërë në 6 muajt e parë të vitit 2023 në infrastrukturën shëndetësore të Kryeqytetit!**

KENDRA E MJEKËSISË FAMILJARE  
VETERNIK





- Kemi filluar me zbatimin e programit “Vizitat në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0 deri në 3 vjeç”, i cili shënon një hap tejet të rëndësishëm në ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor në qytetin tonë.
- Në Qendrën për Mirëqenien e Gruas, kemi hapur qendren informuese për shëndetin e gruas. Kjo qendër do të shërbejë si një hapësirë e sigurt për gratë, ku përmes terapisë grupore dhe këshillimit nga profesionistët shëndetësor ato do të shkëmbejnë përvojat për të pasur një shtatëzani sa më të shëndetshme. Në këtë qendër do të zhvillohen programet “Klasat për Nëna” dhe “Kujdesi grupor në 1000 ditët e para në shëndet”. Faleminderit partnerëve tanë “Action for Mothers and Children”, “EBRD Community Initiative” dhe “Horizon 2020” për mbështetjen.

## “ SPITALI I PRISHTINËS PO VJEN

Kemi bere prezentimin e planit të detajuar për Spitalin Gjeneral të Prishtinës, ndërtimi i të cilit pritet të fillojë këtë vit! Për Spitalin janë ndarë parcela tokësore në Prishtinën e Re dhe buxhet prej 1.3 milionë EUR për fillimimin e punimeve. Spitali do të ketë rreth 200 shtretër, me disa departamente kryesore, si: 1. Kirurgjia, 2. Internistika 3. Gjinekologjia dhe 4. Pediatria. Faleminderit partnerëve tanë nga ICME, për punën fantastike në krijimin e një objekti të denjë që do të plotësojë të gjitha kushtet e qytetarëve të Prishtinës.

- Kemi rritur për 100% shërbimet laboratorike për hormone të gjëndrrës tiroide dhe mbi 400% për HbA1c në Kryeqytet. Drejtorja e Shëndetësisë ka punuar duke rritur shërbimet laboratorike në QKMF dhe QMF për vitin 2023. Nga 1 shkurti i këtij viti në laboratorin e QKMF-së dhe QMF në Dardani analizat e hormoneve të gjëndrrës tiroide dhe analiza e HbA1C-së për diabet kanë filluar që të bëhen çdo ditë pune nga e hëna deri të premtën. Kjo ka ndikuar që të rriten këto shërbime më shumë se 100% gjatë kësaj periudhe.
- Në Lagjen Veternik të Kryeqytetit kemi hapur Qendrën e Mjekësisë Familjare. Nga tash e tutje të gjithë banorët e kësaj zone mund të marrin shumë shërbime në këtë QMF nga stafi i përkushtuar i profesionistëve shëndetësor në mjekësi familjare, vaksinim, radiologji, mamografi si dhe mund të bëjnë analiza laboratorike. Qendra e Mjekësisë Familjare në Veternik ofron edhe shërbimin urgjent.




## 300.000€

- Kemi dorezuar aparatura mjekësore me kosto afër 300.000€. Shërbimi në sektorin primar është i domosdoshëm dhe jemi duke përmirësuar kushtet në të gjitha nivelet, që qytetarët të mund të marrin shërbime në sektorin primar pa pasur nevojë të shkojnë në atë sekondar apo terciar. Kemi arritur të sigurojmë një sasi të madhe aparaturash, përfshirë 230 Stetoskopë, 200 Tensionmetra, 120 Pulksosimetra për tavolina, 5 Ultrazëra për përdorim gjeneral, numërues hematologjik, analizues biokimik me sistem të hapur, EKG- elektrodiagram, glikometër, turbina stomatologjike, Otokop/Oftalmoskop, kundërkënde stomatologjike etj. Aparaturat e reja do të rrisin cilësinë dhe kapacitetin e shërbimeve mjekësore të cilat do të shpërndahen në QKMF në pjesë të ndryshme të kryeqytetit.



# Prishtina për **TEKNOLOGJINË**

“ *Në vazhdim po paraqesim investimet që kemi bërë në 6 muajt e parë të vitit 2023 në infrastrukturën sportive të Kryeqytetit!*





■ Ne bashkëpunim me Albanian Cyber Association, Ambasaden Amerikane dhe Agjencine për Informim dhe Privatësi, sollëm në kryeqytet Konferencën Ndërkombëtare “Cyber Zero”. Jemi të përkushtuar të ndihmojmë në shtimin e kuadrove të reja në sektorin e IT-së, duke mbështetur iniciativa të tilla dhe duke krijuar infrastrukturën e duhur për lulëzimin e këtij sektori. Jemi te bindur se njohuritë dhe përvojat që do të ndahen gjatë këtyre ditëve do të jenë të paçmueshme në luftën tonë të vazhdueshme kundër krimit kibernetik.

■ Kemi nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, e cila do të sigurojë thjeshtimin dhe përsheptimin e procedurave; zvogëlimin e shpenzimeve dhe lehtësimin e komunikimit mes dy institucioneve tona, me qëllim të realizimit të punës sa më efektive dhe interesit publik të qytetarëve të Prishtinës.

■ Përmbyllëm me sukses, për 6 ditë, me 35 organizata dhe kompani partnere, dhe me më shumë se 70 aktivitete, edicionin e dytë VAJZAT NË TIK 2023. Jemi krenarë me entuziazmin dhe pasionin e çikave tona për të zhvilluar sektorin e TIK-ut në vendin tonë. Ato do të jenë lideret e së ardhmes, ndërsa ne jemi këtu për t’ua dhënë krejt përkrahjen e nevojshme.

■ Kemi mbështetur hapjen e kampusit të parë të rrjetit global të ‘School 42’ në Kryeqytet. Ky koncept i veçantë i shkollës së kodimit, pa profesorë e kurse tradicionale, tërësisht FALAS, pa kërkesa paraprake do të filloj vitin e ardhshëm dhe do të ofroj mundësi të jashtëzakonshme për të gjithë ata mbi 18 vjeç që dëshirojnë të zhvillojnë shkathtësitë e tyre në fushën e teknologjisë. Kampusi ynë i ri do të jetë një qendër e inovacionit dhe një burim i madh talenteve të reja për tregun e punës në Kosovë. Ne jemi krenarë dhe entuziazmuar për këtë projekt të rrallë dhe historik.



# Prishtina për **SIGURINË**

“ Në vazhdim po paraqesim investimet që kemi bërë në 6 muajt e parë të vitit 2023 në infrastrukturën për siguri të Kryeqytetit!

INSPEKSIONI  
Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina



INSPEKSIONI  
Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina



INSPEKSIONI  
Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina



- Qendra për trajtimin e qenve endacak është në fazën finale të ndërtimit. Objekti ka marrë formë dhe janë duke u përfunduar punimet e brendshme. Me përfundimin e këtij objekti, të gjithë qentë endacak të identifikuar në territorin e kryeqytetit do të trajtohen - vaksinohen, shërohen dhe kastrohen/sterilizohen në këtë qendër. Shumë shpejt do të fillojmë edhe me ndërtimin e Parkut të Kafshëve, me fokus në qentë me dhe pa pronarë, në një sipërfaqe prej 10 hektarëve në fshatin Slivovë. Ndërtimi i Parkut tashmë është në fazën përgatitore të procedurave të brendshme të domosdoshme për realizimin e tij.
- Kemi punuar në vazhdimësi për lirimin e komunikacionit nga parkimi dhe qarkullimi i taksive ilegal dhe autobusëve ndërurban nëpër kryeqytet. Aksioni i inspektorëve të rendit komunal, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës po bëhet për të evituar ngarkesën e cila po krijohet nga këta operatorë - me qëllim që të njëjtit të kenë Stacionin e Autobusëve si pikë të vetme ndalese dhe të paguajnë taksën e përcaktuar nga kjo ndërmarrje! Kontrollat e tilla do të vazhdojnë deri në vetëdijësimin e plotë - rregullat duhet të zbatohen nga të gjithë!
- Kemi krijuar grupin punues për mbrojtjen e të drejtave të kafshëve! Kemi takuar aktivistet nga shoqëria civile për të biseduar për çështjen e trajtimit të qenve. Vendosëm të bashko-



- hemi në një grup punues, që përfshin përfaqësues nga komuna, aktivistë dhe anëtarë të shoqërisë civile. Synimi ynë është të hartojmë rregullore për trajtimin e qenve me pronar dhe pa pronar dhe të përgatisim kontratën për adoptim të qenve. Çështja e qenve endacakë po trajtohet seriozisht dhe se të gjitha shqetësimet, kërkesat dhe ankesat e palëve do të marrin vëmendjen e duhur nga Kryeqyteti.
- Kryeqyteti do të vendosë kamera në institucionet shkollore! Jemi duke krijuar mjedis ku mund të zhvillohet procesi arsimor për zhvillimin e qëndrueshëm të nxënësve dhe të personelit arsimor. Në përpjekje për të krijuar një ambient më të sigurt dhe të frytshëm për nxënësit tanë të dashur, jemi duke ndërmarrë masa të reja të rëndësishme të sigurisë. Me qëllim që të kontrollojmë më mirë situatën dhe të ndërtojmë një sistem të sigurisë më të fortë, do të vendosim kamera të sigurisë në institucione edukative arsimore në Prishtinë. Kjo do të na ndihmojë të monitorojmë aktivitetet dhe të parandalojmë situata të rrezikshme që mund të ndodhin në ambientet shkollore. Në përpjekjen tonë për të forcuar sigurinë dhe rendin në shkolla, prezencën e policisë në institucionet arsimore do ta bëjmë të rregullt dhe të ndjeshme. Kjo do të krijojë një ndjesi të sigurisë për të gjithë nxënësit dhe stafin shkollor.



# Prishtina për **BUJQESINË**

“ Në vazhdim po paraqesim investimet që kemi bërë në 6 muajt e parë të vitit 2023 në infrastrukturën bujqesore të Kryeqytetit!





- Drejtoria e Bujqësisë ka ndarë 19 serra me nga 5 ari. Përgëzojme bujqit përfitues dhe urojmë të kenë shtim të rendimenteve për këtë vit! Komuna e Prishtinës do të vazhdojë mbështetjen direkte për bujqit dhe fermerët tanë.
- Në këto ditë vape po vazhdon ujitja e tokave bujqësore përmes sistemit të Ibër-Lepencit. E gjithë kostoja e ujitjes së tokave bujqësore që kanë qasje në sistemin e Iber-Lepencit, po mbulohet nga Drejtoria e Bujqësisë.

“

## 54 KULTIVATORË

Po i ndajmë 54 kultivatorë për fermerët e Komunës së Prishtinës, projekt i Drejtorisë së Bujqësisë, i bashkëfinancuar nga Islamic Relief.



- Trefish më shumë subvencione për gra fermere në Kryeqytet. Po vazhdojmë të punojmë në masa afirmative për subvencionet e ardhshme që inkurajojnë ndryshimet në mendësi dhe fuqizim ekonomik real të gruas fermere. Një grua fermere e subvencionuar, ndihmon plot gra të tjera të punësuar nga ajo dhe plot vajza të reja që përfundojnë studimet në teknologji ushqimore për të i fuqizuar tutje ato.

**230**

- Drejtoria e Bujqësisë ka subvencionuar me pagesa direkte 230 fermerë që mbajnë lopë, dele dhe dhi.

[prishtinaonline.com](http://prishtinaonline.com)

